



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 357/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 11.12.2010, mori këtë:

VENDIM

HIDHET poshtë ankesa si e parregullt.

ARSYETIMI

Më datë 08.12.2010 PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik AAK, ne te cilën pretendohet se me 5 Dhjetor 2010 mbas dite rreth orës 15:00 në Lipjan anëtarët e subjektit politik PDK kanë vendosur posterat e kandidatës për deputete Justina Pula Shiroka mbi posterat e kandidatit nga rradhët e AAK Shkëlzen Jusaj, qe përben shkelje te nenit 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 nenit 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.*

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posterit i kandidatës për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Justina Pula Shiroka, nga rradhët e subjektit politik PDK, është vendosur mbi posterat e Shkëlzen Jusaj kandidat për deputet nga rradhët e AAK-së. Parashtruesi i ankesës propozon qe të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Me rendesi eshte fakti, se parashtruesi i ankesës nuk e ka vërtetuar përmbajtjen e pretendimeve, për arsye se ne formularin e ankesës se pranuar prej PZAP ne date 08.12.2010 nuk është hedhur asnjë firmë prej asnjë personi te autorizuar te subjektit politik AAK.

Ne kuptim te nenit 118 paragrafi 1 te LZP-së dhe nenit 3.6, pika (d) te Rregullave dhe Procedurave te PZAP parashihet si vijon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

3.6 “ Te gjitha ankesat duhet te kenë se paku informacionet vijuese:

..... (d) vërtetimin nga pala ankuese lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së ankesës”.

Nga shkresat e lendes PZAP-i konstaton se ankesa është e parregullt për faktin se formulari i ankesës nuk përmbush kushtet e lartpërmendura, **parashtruesi i ankesës nuk e ka nënshkruar ankesën e paraqitur, per kete arsye dhe duke u bazuar ne në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 357/2010 më datën 11.12.2010

Kryesuesi i Panelit

Emër Hoxha

